

Detajet e çështjes

Nr. i çështjes: 31010-00666-86-2015

Data e regjistrimit: 18-02-2015

Palët

Paditës: Anardi Fero

I paditur: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Policisë Qarku Korçë

Objekti: Shfuqizimin e aktit administrativ urdherit nr 1900 dt 11.04.2014 "për lirimin nga policia e shtetit të një punonjësi policie" të Drejtorit të Policisë së Qarkut Korçë, I cili ka sjelle dhe nderprerje të menjehershme të marrëdhënies së punës për shkaqe të pajustificuara

Relatori: Amarildo Laçi

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Korçë, me vendimin Nr. 674, datë 20.11.2014, ka vendosur:

- Pranimin pjesërisht të padisë.
- Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Policisë Qarku Korçë të dëmshpërblejë paditësin Anardi Fero në masën e pagës së 12 muajve pune, për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të ligjshme. Ky detyrim duhet të përmbushet nga debitori Drejtoria e Policisë Qarku Korçë, brenda 12 muajve nga data e marrjes formë të prerë të këtij vendimi, duke derdhur në llogarinë bankare të kreditorit Anardi Fero, në 12 këste të barabarta mujore shumën përkatëse monetare dhe është një detyrim i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor.
- Rrëzimin e padisë lidhur me palën e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, si dhe lidhur me kërkimet e tjera në padi si të pabazuar në prova dhe në ligj. · Shpenzimet gjyqësore janë në ngarkim të palëve ndërgjyqëse në raportet 1/4 në ngarkim të palës së paditur Drejtoria e Policisë Qarku Korçë dhe 3/4 në ngarkim të palës paditëse. Ky detyrim duhet të përmbushet nga debitori Drejtoria e Policisë Qarku Korçë pas marrjes formë të prerë të këtij vendimi, duke derdhur në llogarinë bankare të kreditorit Anardi Fero shumën përkatëse monetare dhe është një detyrim i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë,

Gjykata Administrative e Apelit vendosi:

Ndryshimin e vendimit Nr. 674, datë 20.11.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Korçë:

Data e

shpalljes: 11-05-2017